



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republika of Kosovo

0.P.R.
02-085/2026
28.05.2026
ОПШТИНА РАНИЛУГ - KOMUNA E RANILLUGUT



Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranillugu

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 40, paragrafi 40.2 pika (d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e R.K." nr. 28/2008), nenit 15, paragrafët 15.1 dhe 15.3 pika (g), të Statutit të Komunës së Ranillugut nr. 02-154/2011, Kuvendi Komunal i Ranillugut, në mbledhjen e pestë të rregullt të mbajtur më 28.05.2026, miratoi:

**VENDIM PËR
FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS SË
KUVENDIT TË KOMUNËS SË RANILLUGUT PËR VITIN 2026**

1.

Propozim-vendimi i paraqitur ka kaluar shqyrtimin kryesor në mbledhjen e pestë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ranillugut, të mbajtur më 28.05.2026, ku është miratuar dhe aprovuar me shumicë votash.

2.

Miratohet Vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Ranillugut për vitin 2026, në përbërjen si vijon:

- Ivan Krstiq, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ranillugut,
- Snezhana Ristiq, anëtare e Kuvendit Komunal,
- Davor Stojanoviq, anëtar i Kuvendit Komunal,
- Ollgica Trajkoviq, anëtare e Kuvendit Komunal,
- Nenad Jovanoviq, anëtar i Kuvendit Komunal.

3.

Detyrë e komisionit të përmendur në pikën 2 të këtij Vendimi është që, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë që Kuvendi i Komunës ka sipas dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, akteve nënligjore dhe Statutit të Komunës, të hartojë Planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026. Pas hartimit të planit përfundimtar, komisioni do ta paraqesë të njëjtin para Kuvendit të Komunës për miratim.

4.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

Data: 28.05.2026

Ranillug



Kryesues i KK së Ranillugut

Ivan Krstiq